

UDHËZIM
Nr.2, datë 1.8.2008

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.848, DATË 11.6.2008 “PËR KTHIMIN E FONDEVE FINANCIARE NGA SUBJEKTET, QË KANË PËRFITUAR NGA PËRDORIMI I FONDEVE TË GRANTEVE JAPONEZE SI MBËSHTETJE BUXHETORE “NON PROJECT GRAND AID” (NPGA), PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.848, datë 11.6.2008 “Për kthimin e fondeve financiare nga subjektet, që kanë përfituar nga përdorimi i fondeve të granteve japoneze si mbështetje buxhetore “Non Project Grand Aid” (NPGA), për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit të Këshillit të Ministrave”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konusmatorit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Të gjitha subjektet përfituese të NPGA (Non Project Grand Aid), që janë financuar nga njësia e menaxhimit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2 KR”, për periudhën nga 1999 e në vazhdim, të lidhin kontratë të shitjes me rezervë me projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për linjat teknologjike të agropërpunimit.

2. Autorizohet drejtori i projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për lidhjen dhe nënshkrimin e kontratave me subjektet përfituese.

3. Vlera financiare e përfituar për linjat teknologjike, që janë financuar nga “Non Projekt Grant Aid” në kuadër të granteve japoneze, të shlyhen si fonde kundërparti nga subjektet përfituese me këste, pa interes, me vlerën e barasvlefshme në “lekë” të çmimit të blerjes FOB, deri në qershor të vitit 2013. Konvertimi në lekë i çmimit të blerjes FOB të bëhet sipas kursit zyrtar të këmbimit të valutës në lekë, në datën 11.6.2008 sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.848, datë 11.6.2008.

4. Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” të lidhë kontratat me subjektet përfituese me afat deri në fund të qershorit të vitit 2013.

5. Diferencat financiare ndërmjet çmimeve CIF dhe FOB, të evidentohen nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” në pakësim të fondeve kundërparti.

6. Brenda strukturës organizative të miratuar të sektorit të fondit kundërparti, drejtori i projektit ngarkon specialistë të veçantë për monitorimin, menaxhimin e linjave dhe kthimin e fondit kundërparti nga çdo subjekt. Këta specialistë mbajnë dokumentacion të plotë dhe ndjekin punën për shlyerjen e vlerës së përcaktuar të linjave të agropërpunimit.

7. Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, në bashkëpunim me organet tatimore, ka të drejtë të ushtrojë kontroll teknik e financiar mbi veprimtarinë ekonomike që subjekti kryen, gjendjen teknike etj., për disa kohë që nuk është paguar kësti i fundit.

8. Subjekti përfitues është i detyruar të raportojë e të japë informacion në projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për të dhënat që i kërkohen prej tij dhe mban përgjegjësi për saktësinë e tyre.

9. Numri i kërkesave për çdo vit kalendarik të jetë 2-3, ky numër përcaktohet në mirëkuptim midis palëve dhe do të pasqyrohet në kontratë.

10. Kuotat e arkëtimit të kësteve përcaktohen në mirëkuptim midis palëve dhe do të pasqyrohen në kontratën e lidhur midis projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” dhe subjekteve përfituese të NPGA-së.

11. Subjekti përfitues mund të bëjë në çdo kohë likuidim të menjëhershëm të disa kësteve, kjo e parashikuar në kontratën ndërmjet palëve.

12. Për rastet e mospagimit në kohë të këstit, subjekti përfitues i linjave të agropërpunimit

penalizohet me një kamatëvonesë vjetore prej 5% të vlerës së papaguar të kështit, e llogaritur kjo për çdo ditë pune.

13. Në rast se subjekti përfitues nuk pranon të nënshkruajë kontratën me projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” apo nuk paguan kështet e radhës, organet tatimore në bashkëpunim me projektin “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, kryejnë bllokimin e aktivitetit ekonomik të subjektit dhe nisin procedurat e sekuestrimit të linjës së agropërpunimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

14. Kur subjekti përfitues, pagues i rregullt i kësteve, nuk paguan dy këste të radhës të cilat janë të pasqyruara në kontratë, linja e agropërpunimit sekuestrohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pa asnjë rimbursim të kësteve të mëparshme.

15. Në rast sekuestrimi, organet kompetente bllokojnë veprimtarinë ekonomike të subjektit dhe projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” planifikon punën për çmontimin e linjës dhe rishpërndarjen e saj në subjekte të reja përfituese, duke respektuar udhëzimet në fuqi.

16. Kalimi i pronësisë së linjave të agropërpunimit nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” te subjekti përfitues, bëhet vetëm pasi ky i fundit të ketë likuiduar edhe kështin e fundit në përputhje me kontratën duke shlyer vlerën FOB të linjës.

17. Të gjitha arkëtimet e kryera nga subjektet përpara lidhjes së kontratës, të provuara nga ana e tyre si arkëtime në favor të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” për likuidimin e linjës do të përfshihen në pagesën e kështit/-ve të fundit.

18. Nuk përbëjnë arkëtim në favor të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” të gjitha arkëtimet të kryera ndaj të tretëve, agentë sigurimesh etj., si dhe çdo pagesë tjetër që nuk ka mbërritur në llogarinë e projektit 2KR.

19. Me mbylljen e arkëtimeve që përbën vlerën e plotë të detyrimit kontraktual, projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR” i kalon pronësinë subjektit përfitues duke e pajisur atë me “Vërtetim pronësie”.

20. Për rastet e patrajuara nga ky udhëzim, nëse gjykohet për efekt të fakorëve objektivë, me propozim të drejtorit të projektit “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit përcakton mënyrën e zgjidhjes me urdhër të veçantë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode